



EACS
European
AIDS
Clinical
Society

UDHËZUES

Versioni 7.1

Nëntor 2014

Shqip

Tabela e Përmbajtjes

Anëtarët e Bordit Drejtues	2
Anëtarët e Panelit	2
Shkurtimet	3

Pjesa I

Vlerësimi i personave të infektuar me HIV në vizitën e parë dhe ato pasuese	4
--	----------

Pjesa II

Terapia Antiretrovirale (ART) te pacientët e infektuar me HIV	6
Vlerësimi i gadishmërisë për të filluar dhe vazhduar ART tek personat HIV pozitivë	6
Rekomandime për iniciimin e ART tek personat HIV-pozitivë të paekspozuar më parë ndaj ART	7
Regjimi fillestar i kombinuar për persona adult HIV pozitivë – naivë ndaj ART	8
Infeksioni akut i HIV	9
Strategjitë e ndryshme të terapisë për pacientët me virologji të supresuar	10
Dështimi Virologjik	11
Trajtimi i grave HIV-pozitive shtatëzëna	12
ART në bashkë-infeksionin TB/HIV	13
Profilaksia pas ekspozimit	14
Efektet e padëshirueshme të ARV-ve dhe klasat e barnave	15
Ndërveprimet midis barnave ARV dhe jo ARV	17
Ndërveprimet midis barnave Anti-depresantë dhe ARV	18
Ndërveprimet midis barnave Anti-hipertensivë dhe ARV	19
Ndërveprimet midis barnave Analgjezikë dhe ARV	20
Ndërveprimet midis barnave Anti-malaria dhe ARV	21
Rregullimi i dozës të ARV-ve për funksione hepatike të dëmtuara	23
Rregullimi i dozës të ARV-ve për funksione të dëmtuara të veshkave	24
Administrimi i ARV-ve tek personat me vështirësi në gjellitje	25

Pjesa III

Parandalimi dhe Menaxhimi i komorbideve tek personat HIV pozitivë	27
Dipendenca nga droga dhe Varësia nga droga	28
Kanceri: Metodët e Skrimit	29
Ndërhyrjet në stilin e jetës	30
Parandalimi i CVD	31
Diagoza e Hipertensionit, Shkallët dhe administrimi	32
Diagoza e Hipertensionit, Shkallët dhe administrimi	33
Ndërveprimi midis barnave Anti-hipertensivë dhe ARV	34
Diabeti i Tipit 2: Diagnoza	35
Diabeti i Tipit 2: Administrimi	36
Dislipidemia	37
Sëmundjet e kockave: Skrimit dhe Diagnoza	38
Defiçenca e Vitaminës D: Diagnoza dhe Administrimi	39
Qasja ndaj reduktimit të frakturave te Personat HIV pozitivë	40
Sëmundjet e Veshkave: Diagnoza dhe Administrimi	41
Nefrotoksiciteti shoqëruar i ARV-ve	42
Indikacionet dhe Testet për Tubulopatinë Renale Proximale (TRP)	43
Rregullimi i dozave të ARV-ve gjatë funksionit renal të dëmtuar	44
Ekzaminimi Work-up dhe Menaxhimi tek Personat HIV-pozitivë me ALT/AST të rritura	45
Ceroza e Mëlçisë: Klasifikimi dhe Mbikqyrja	46
Ceroza e Mëlçisë: Administrimi	47
Diagoza dhe Administrimi i Sindromës Hepatorenale (HRS)	48
Rregullimi i dozave të ARV-ve për Funksion Hepatik të dëmtuar	49

Lipodistrofia: Parandalimi dhe Administrimi	50
Hiperlaktatemia dhe Acidoza laktike: Diagnoza, Parandalimi dhe Administrimi	51
Udhëtimi	52
Ndërveprimet midis barnave Anti-malaria dhe ARV-ve	53
Vaksinimi	55
Shëndeti seksual dhe riprodhues i femrave dhe meshkujve HIV-pozitivë	56
Mosfunksionimi seksual	57
Trajtimi i mosfunksionimit seksual tek meshkujt HIV-pozitivë	58
Depresioni: Depistimi dhe Diagnoza	59
Depresioni: Administrimi	60
Klasifikimi, Dozat, Siguria dhe efektet e padëshirueshme të barnave Antidepresantë	61
Ndërveprimi midis barnave Antidepresantë dhe ARV-ve	62
Algoritmi për Diagnozën dhe Menaxhimin e dëmtimit neurokognitiv të asociuar me HIV-in tek personat pa kondicione të dukshme konfonduese	63

Pjesa IV

Menaxhimi klinik dhe trajtimi i bashkë-infeksioneve HBV dhe HCV tek Personat HIV-pozitivë	64
Rekomandimet e përgjithshme për Personat me Bashkë-infeksion të Hepatitit Viral/HIV	64
Vlerësimi i treguesve të trajtimit për HBV tek Personat me bashkë-infeksion HBV/HIV	65
Trajtimi i HBV kronik tek Personat me bashkë-infeksion HBV/HIV	66
Procedurat e diagnostikimit për HCV tek personat me bashkë-infeksion HCV/HIV	67
Trajtimi i HCV tek Personat me bashkë-infeksion HCV/HIV	68
Menaxhimi i Personave me bashkë-infeksion HCV kronik /HIV	70
Opsionet e trajtimit HCV te personat me bashkë-infeksion HCV/HIV	71
Ndërveprimet midis DAA-ve dhe ARV-ve	72
Propozimi i kohëzgjatjes optimale të terapisë së dyfishtë HCV tek Personat me bashkë-infeksion kronik HCV/HIV,që nuk mund të përfshihen në terapinë e tre-fishtë DAAs kundër HCV	73
Përdorimi i Boceprevir dhe Telaprevir te Personat me bashkë-infeksion HIV/HCV	74
Përkufizimi i reagimit ndaj trajtimit të PEG-IFN dhe RBV	75

Pjesa V

Infeksionet Oportuniste	76
Parandalimi dhe Trajtimi i infeksioneve oportuniste tek personat HIV-Pozitivë	76
Diagoza dhe Trajtimi i TB te personat HIV-pozitivë	82

Referencat

Referencat në të gjitha seksionet	85
--	-----------

Udhëzimet EACS disponohen online në www.eacsociety.org dhe në aplikacionin EACS Guidelines App

Stampimi
Publikues: Shoqata Klinike Europiane për AIDS (EACS)
Pjesëtarë të Panelit: Jens D. Lundgren (Koordinator i Udhëzuesit), Jose M Gatell, Hansjakob Furrer, Jürgen Rockstroh
Koordinatori Asistent i Udhëzuesit: Lene Ryom
Grafik Dizajni: Notice Kommunikation & Design, Zurich
Përkthim: SEVT Ltd., Londër
Versioni 7.1 Nëntor 2014

Këto udhëzime janë hartuar nga Shoqata Klinike Evropiane për AIDS (EACS), një organizatë jo-fitimprurëse, misioni i të cilës është promovimi i standarteve më të mira të kujdesit, kërkimit dhe edukimit në lidhje me infeksionin HIV dhe bashkë-infeksionet e lidhura me të. Gjithashtu, ka për qëllim angazhimin në mënyrë aktive në formulimin e politikave të shëndetit publik për reduktimin e barrës të infeksionit HIV në të gjithë Evropën.

Anëtarët e Panelit

Sekretariati Mjekësor

Sekretariati Mjekësor i EACS është përgjegjës për koordinimin dhe përditësimin e udhëzimeve të EACS bazuar në rekomandimet nga katër panelet e EACS-it.

Kryetari dhe Koordinatori i Udhëzuesit:

Jens D Lundgren **Kopenhagen, Danimarkë**
Koordinatori Asistent: Lene Ryom **Kopenhagen, Danimarkë**

Trajtimi i HIV-it

Kryetar: Jose M Gatell **Barcelonë, Spanjë**
Zv/ Kryetar: Anton Pozniak **Londër, Mbretëri e Bashkuar**
Shkencëtar i ri: Christian Manzardo **Barcelonë, Spanjë**
 Antonella d'Arminio Monforte **Milano, Itali**
 Jose Arribas **Madrid, Spanjë**
 Manuel Battegay **Basel, Zvicër**
 Nathan Clumeck **Bruksel, Belgjikë**
 Nikos Dedes **Athinë, Greqi**
 Anna Maria Geretti **Liverpool, Mbretëri e Bashkuar**
 Anders Horban **Varshav, Poloni**
 Christine Katlama **Paris, Francë**
 Jens D. Lundgren **Kopenhagen, Danimarkë**
 Christina Mussini **Modena, Itali**
 François Raffi **Nantes, Francë**
 Peter Reiss **Amsterdam, Hollandë**
 Hans Jürgen Stellbrink **Hamburg, Gjermani**

Bashk-sëmundshmëritë

Kryetar: Jens D Lundgren **Kopenhagen, Danimarkë**
Zv/Kryetar: Georg Behrens **Hanover, Gjermani**
Shkencëtar i ri: Lene Ryom **Kopenhagen, Danimarkë**
 Manuel Battegay **Basel, Zvicër**
 Mark Bower **Londër, Mbretëri e Bashkuar**
 Paola Cinque **Milano, Itali**
 Simon Collins **Londër, Mbretëri e Bashkuar**
 Juliet Compston **Cambridge, Mbretëri e Bashkuar**
 Gilbert Deray **Paris, Francë**
 Stéphane De Wit **Bruksel, Belgjikë**
 Christoph A. Fux **Aarau, Zvicër**
 Giovanni Guaraldi **Modena, Itali**
 Patrick Mallon **Dublin, Irlandë**
 Esteban Martinez **Barcelonë, Spanjë**
 Catia Marzolini **Basel, Zvicër**
 Sokratis Papapoulos **Leiden, Hollandë**
 Renaud du Pasquier **Lozhan, Zvicër**
 Neil Poulter **Londër, Mbretëri e Bashkuar**
 Peter Reiss **Amsterdam, Hollandë**
 Alessandra Viganò **Milano, Itali**
 Ian Williams **Londër, Mbretëri e Bashkuar**
 Alan Winston **Londër, Mbretëri e Bashkuar**

Bashkë-Infeksionet

Kryetar: Jürgen Rockstroh **Bon, Gjermani**
Zv/Kryetar: Massimo Puoti **Milan, Itali**
Shkencëtar i ri: Christoph Boesecke **Bon, Gjermani**
 Sanjay Bhagani **Londër, Mbretëri e Bashkuar**
 Raffaele Bruno **Pavia, Itali**
 Diego Garcia **Sevilla, Spanjë**
 Maxime Journiac **Paris, Francë**
 Karine Lacombe **Paris, Francë**
 Stefan Mauss **Dusseldorf, Gjermani**
 Lars Peters **Kopenhagen, Danimarkë**
 Vicente Soriano **Madrid, Spanjë**
 Andri Rauch **Bern, Zvicër**
 Cristina Tural **Barcelona, Spanjë**
 Chris Ward **Cardiff, Wales**

Infeksionet oportuniste

Kryetar: Hansjakob Furrer **Bern, Zvicër**
Zv/Kryetar: Jose M Miro **Barcelonë, Spanjë**
Shkencëtar i ri: Valentin Gisler **Bern, Zvicër**
 Luigia Elzi **Basel, Zvicër**
 Paola Cinque **Milano, Itali**
 Gerd Fätkenheuer **Kolonjë, Gjermani**
 Ole Kirk Kopenhagen, Danimarkë
 Amanda Mocroft **Londër, Mbretëri e Bashkuar**
 Philippe Morlat **Bordo, Francë**
 Anton Pozniak **Londër, Mbretëri e Bashkuar**
 Alain Volny-Anne **Paris, Francë**

Anëtarët e Bordit Drejtues

Manuel Battegay (President) **Basel, Zvicër**
 Fiona Mulcahy (Nënkryetare) **Dublin, Irland**
 Anna Maria Geretti (Sekretare) **Liverpool, Mbretëri e Bashkuar**
 Nathan Clumeck (Arkëtar) **Bruksel, Belgjikë**
 Peter Reiss **Amsterdam, Hollandë**
 (ish President)
 Jose Arribas **Madrid, Spanjë**
 Antonella d'Arminio Monforte **Milano, Itali**
 Cristiana Oprea **Bukuresht, Rumani**
 Cristina Mussini **Modena, Itali**
 Jose Gatell **Barcelonë, Spanjë**
 Christine Katlama **Paris, Francë**
 Jens D. Lundgren **Kopenhagen, Danimarkë**
 Anton Pozniak **Londër, Mbretëri e Bashkuar**
 Jürgen Rockstroh **Bon, Gjermani**
 Mike Youle **Londër, Mbretëri e Bashkuar**

Shkurtime:

Shkurtime e ilaçeve Antiretrovirale (ARV)		Shkurtesa të tjera	
3TC	lamivudin	FTRN	frenuesit nukleosid të transkiptazës reverse
ABC	abakavir	NFTRN	frenuesit jo-nukleosid të transkiptazës reverse
ATV	atazanavir	NVP	nevirapinë
COBI	kobikistat	PI	frenuesit proteazës
d4T	stavudinë	PI/r	frenuesit proteazës të përforcuar
ddl	didanozinë		farmakologjikisht me ritonavir
DLV	delavirdinë	RAL	raltegravir
DRV	darunavir	RPV	rilpivirinë
DTG	dolutegravir	RTV	ritonavir (përdorur si shtesë=/r)
EFV	efavirenz	SQV	sakuinavir
EVG	elvitegravir	TDF	tenofovir
ENF	enfuvirtidë	TPV	tipranavir
ETV	etravirinë	ZDV	zidovudinë
FI	Inhibitor fuzioni		
FPV	fosamprenavir		
FTC	emtricitabinë		
IDV	indinavir		
INSTI	frenues të integrazës strand transfer		
LPV	lopinavir		
MVC	maravirok		
ACE	enzimë konvertimi angiotensin	HIVAN	nefropati e asociuar me HIV-in
ALP	fosfatazë alkaline	HPV	Virusi human papilloma
ALT	aminotransferase alanine	HSR	reaksion hipersensitiv
aMDRD	modifikim i shkurtuar i dietës në formulën e sëmundjeve renale	IGRA	interferon-gamma release assay
ART	terapi me antiretrovirale	IHD	sëmundje ishemikezemre
AST	aspartate	IM	intramuskular
BMD	aminotransferase dëndësia minerale kockave	IV	intravenoz
BMI	Indeksi i masës trupore	IVDU	përdorim intravenozdroge
BP	presioni gjakut	LDL-c	LDL-kolesteroli
cART	tTAR e kombinuar	LGV	limfogranuloma venerike
CKD	sëmundje kronike e veshkave	Mg	magnezium
CMV	citomegalovirus	MSM	meshkuj që kanë sëks me meshkuj
CNS	sistemi nervor qendror	PO	për oral
COPD	Semundje pulmonare obstruktive kronike	PAP	testi papanikolaou
CSF	lëngu cerebrospinal	PEG-IFN	pegylated-interferon
CVD	sëmundje kardiovaskulare	PPI	frenuesi proton pump
CXR	X-ray kraharori	PPD	derivat proteinik i purifikuar
DAA	barna me veprim direkt	PSA	antigen specifik prostate
DXA	energji dual X-ray absorptiometri	PTH	hormonet paratiroide
ECG	elektrokardiogram	RBV	ribavirin
eGFR	shkalla e estimuar e filtrimit glomerular	SC	nënlekurë
FBC	numërimin e plotë të gjakut	SVR	përgjigje virologjike qëndrueshme
FDC	kombinim doze fikse	STI	Infeksione seksualisht të transmetueshme
FRAX	Instrument për vlerësimin e rrezikut të frakturës	TC	kolesteroli total
GT	genotipi	TDM	monitorimi terapeutik barnave
HAV	Virusi i Hepatitit A	TG	trigliceridet
HBV	Virusi i Hepatitit B	UA/C	raporti urinë albuminë/kreatininë
HCV	Virusi i Hepatitit C	UP/C	urine protein/kreatininë
HDL-c	HDL-kolesteroli	VL	ngarkesa virale (HIV-RNA)
		WB	western blot
		Zn	zink

Pjesa I Vlerësimi i personave të infektuar me HIV në vizitën e parë dhe ato vijuese

	Vlerësimi	Gjatë diag- nozës HIV	Para fillimit të TAR	Intervalet e ndjekjes	Komente	Shih faqen
HISTORIKU						
Mjeksor	Historiku mjeksor i plotë që përfshin	+	+	Vizita e parë	Transfero për vlerësim për kujdes në vazhdim	
	• Historiku familjar (psh. CVD të parakohshme, diabet, hipertension, CKD)	+		Vizita e parë	CVD të parakohshme: raste kardiovaskulare tek të afërm të shkallës së parë (meshkujt < 55, femrat < 65 vjeç)	31-33
	• Barna shoqëruese ⁽ⁱ⁾	+	+	Në çdo vizitë		
	• Mbivendosja e sëmundjeve të shkuara dhe të tanishme	+	+	Në çdo vizitë		
	• Historiku i vaksinimit	+		Vizita e parë	Matja e antitropave dhe ofrimi i vaksinave atje ku nevojiten	
Psikosocial	Stili aktual i jetesës (përdorimi i alkoolit, pirja e duhanit, dieta, ushtrime, përdorim droge)	+	+	6-12 muaj	Duhet të adresohen më shpesh zakonet negative të jetesës Ofro këshilla dhe mbështetje nëse duhet Siguro këshillim nëse është e nevojshme	30
	Punësimi	+	+	Siç tregohet Në çdo vizitë		
	Mirëqënia Sociale	+	+			
	Problemet Psikologjike	+	+			
Partneri dhe femijët	+			Testoni partnerët dhe fëmijët nëse janë në rrezik		
Shëndeti seksual dhe riprodhues	Historiku seksual	+		6-12 muaj	Adresoni çështjet e mosfunksionimit seksual	56-58
	Seksi i sigurt	+			Adreso rrezikun e transmetimit seksual aty ku nevojitet	
	Statusi i partnerit dhe zbulimi i statusit tek partneri	+			Konsidero fillimin e ART në çiftet serodiskordante	
	Çështjet e konceptimit	+	+			
Sëmundja e HIV-it						
Virologjia	Konfirmimi i HIV Ab pozitiv	+		3-6 muaj Në dështimit virologjik	Monitorimi më i shpeshtë HIV-VL në fillimet e TAR	7-11
	Plazma HIV-VL	+	+		Kryej testin e rezistencës gjenotipike para fillimit të ART nëse nuk është testuar më parë ose në qoftë se ka rrezik për infeksion të lartë	
	Testi gjenotipik; rezistenca dhe nëntipi	+	+/-			
	tropizëm R5 (nëse ka)		+/-		Skrinim nëse konsiderohet antagonizmi i R5 në regjim	
Imunologjia	Vlera absolute e CD4 dhe % (fakultativ: CD8 dhe %)	+	+	3-6 muaj	Merrni parasysht monitorim më pak të shpeshtë për persona në ART me CD4 të lartë ⁽ⁱⁱ⁾	7-11
	HLA B5701 (nëse e mundur)	+	+/-		Skrinim para fillimit të ABC në përbërje të ART, nëse nuk është testuar më parë.	
Bashkë-infeksionet						
IST	Serologji për Sifiliz	+		Vjetor/ siç tregohet	Konsidero skrinim më të shpeshtë nëse ka risk	56
	Skrinim për IST	+		Vjetor/ siç tregohet	Skrinim nëse është në risk	
Hepatitet Virale	Serologji e HAV	+		Vjetor/ siç tregohet	Skrinim për risk; vaksinim nëse është jo-immune	55-56,64
	Skrinim për HCV	+			Skrinim Vjetor për risk të vazhdueshëm Mat HCV-RNA nëse HCV Ab pozitiv ose nëse dyshohet për infeksione akute.	
	Skrinim për HBV	+	+		Skrinim Vjetor tek personat e dyshimtë; vaksinim nëse është jo-immune	
Tuberculozi	CXR	+		Ri-skrinim në se ka ek-spozim	Konsidero CXR rutinë tek personat, nga popullata me prevalencë të lartë TB.	82
	PPD nëse niveli i CD4 >400	+			Shih Diagnoza dhe trajtimi për TB tek personat HIV pozitivë	
	IGRA në popullata të caktuara me risk të lartë (nëse e mundur)	+				
Të tjera	Serologji e virusit Variçela Zoster	+			Ofroni vaksinimin kur nevojitet	55
	Serologjia e Fruth /Rubeolës	+			Ofroni vaksinimin kur nevojitet	
	Serologjia e Toksoplazmozës	+				
	Serologjia e CMV	+				
	Serologjia e Leishmania	+/-			Skrinim sipas historisë/originës së udhëtimit	
	Skrinimi Tropikal (p.sh Serologjia e Skistosomes)	+/-			Skrinim sipas historisë/originës së udhëtimit	

	Vlerësimi	Gjatë diag- nozës HIV	Para fillimit të TAR	Intervalet e ndjekjes	Komente	Shih faqen
Bashkësëmundjet						
Hematologji	FBC	+	+	3-12 muaj		
	Hemoglobinopatia	+			Skrinim për personat në risk	
	G6PD	+			Skrinim për personat në risk	
Përbërja trupore	Indeksi i masës trupore	+	+	Vjetor		30
Sëmundjet Kardiovaskulare	Vlerësimi i rrezikut (rezultati Framingham ⁽ⁱⁱⁱ⁾)	+	+		Duhet të kryhet në të gjithë njerëzit > 40 vjeç dhe femrat > 50 vjeç pa SKV	31
	ECG	+	+/-	Vjetor	Konsidero nivelin fillestar ECG para se të iniciosh ARV-te që asociohen me probleme potenciale në sjellje	
Hipertensioni	Presioni i gjakut	+	+	Vjetor		32-33
Lipidet	TC, HDL-c, LDL-c, TG ^(iv)	+	+	Vjetor	Përsëritni në gjendje perisi nëse përdoret për ndërhyrje mjeksore (p.sh. ≥ 8h pa konsumim kalor-ish)	37
Glukoza	Serum glukoze	+	+	6-12 muaj	Konsideroni testin oral-glukoz të tolerancës të / HbA1c nëse niveli i glukozës është 5.7-6.9 mmol/L (100-125 mg/dL)	35-36
Sëmundjet Pulmonare	CXR	+/-		siç tregohet	Konsideroni CRX nese ka historik paraprak të sëmundjeve pulmonare	
	Spirometri			siç tregohet	Skrinoni për COPD tek personat me rrezik ^(xii)	
Sëmundjet e Mëlçisë	Vlerësimi i rrezikut ^(v)	+	+	Vjetor		45-47
	ALT/AST, ALP, Bilirubina	+	+	3-12 muaj	Monitorimi shumë i shpeshtë para fillimit dhe gjatë trajtimit me barna hepatotoksike	
Sëmundjet Renale	Vlerësimi i rrezikut ^(vi)	+	+	Vjetor	Monitorim i shpeshtë nëse faktorët e rrezikut për CKD janë të pranishëm dhe / ose para nisjes dhe gjatë trajtimit me barna nefrotoksike ^(ix)	41-42
	eGFR (aMDRD ^(vii))	+	+	3-12 muaj		
	Urine dipstick analysis ^(viii)	+	+	Vjetor	Çdo 6 muaj nëse eGFR < 60 mL/min, Nëse proteinuria ≥ 1+ dhe/ose eGFR < 60 mL/min kryej UP/C ose UAC ^(vii)	
Sëmundjet e Kockave	Profili kockor: kalcium, PO4, ALP	+	+	6-12 muaj		38, 40
	Vlerësimi i rrezikut ^(x) (FRAX ^(xi)) tek personat > 40 vjet)	+	+	2 vjet	Konsideroni DXA tek personat specifik	
Vitamina D	25(OH) vitaminë D	+		siç tregohet	Skrinim për personat në risk	39
Dëmtimet Neurokonjitive	Pyetësor Skrinimi	+	+	2 vjet	Skrinim gjithë personave pa kushte konfunduese. Nëse janë jonormal dhe simptomatikë, shih algoritmin faqe 63 për vlerësim të mëtejshëm	63
Depresioni	Pyetësor	+	+	1-2 vjet	Skrinim për personat në risk	59-61
Kanceri	Mamografi			1-3 vjet	Gratë 50-70 vjeçe	29, 47
	PAP Cervikal			1-3 vjet	Femrat seksualisht aktive	
	Anuskopi dhe PAP (MSM)			1-3 vjet	Nuk ka evidenca për përfitimet	
	Ultratinguj dhe alfa-foetoproteina			6 muaj	I diskutueshëm/Persona me cerozë dhe personat me HBV pavarësisht fazës së fibrozës	
	Të tjera				I diskutueshëm	

- i Rishikoni të gjitha medikamentet shoqëruese të cilat potencialisht mund të ndërveprojnë me ARV-te ose rrisin bashkë-infeksionet, shih [Ndërveprimet mes barnave DAAS dhe ARV](#), [Ndërveprimi mes medikamenteve kundër depresionit dhe ARV](#); [Ndërveprimi mes medikamenteve antihipertensivë dhe ARV](#); [Ndërveprimi mes medikamenteve analgjezikë dhe ARV](#); [Ndërveprimi mes medikamenteve antimalarial dhe ARV-ve dhe \[www.hiv-druginteractions.org\]\(#\)](#)
- ii Në rast qëndrueshmërie me ART me NV të pa detektueshme dhe CD4 > 350 / µL, merrni në konsideratë monitorimin e CD4 çdo 6-12 muaj.
- iii Një ekuacion për rrezikun i zhvilluar nga popullatat me HIV është në dispozicion, shih [www.cphiv.dk/tools.aspx](#). Vini re, në qoftë se një individ merr medikamente për të kontrolluar dislipideminë dhe / ose hipertensionin, vlerësimi duhet të interpretohet me kujdes.
- iv Një llogaritje për LDL e kolesterolit në rastet kur TG nuk është e lartë mund të gjendet në [www.cphiv.dk/tools.aspx](#).
- v Faktorët e rrezikut për sëmundjet kronike të mëlçisë përfshijnë alkoolin, hepatitin viral, obezitetin, diabetin, rezistencën ndaj insulinës, hiperlipideminë dhe medikamentet hepatotoksike.
- vi Faktorët e rrezikut për CKD: hipertensioni, diabeti, CVD, historiku familjar, etniciteti i zi Afrikan, hepatiti viral, CD4 aktuale të ulëta, pirja e duhanit, moshë e vjetër, medikamentet shoqëruese nefrotoksike.
- vii eGFR: përdorni modifikim të shkurtuar të dietës në rastin e sëmundjes së veshkave

- (aMDRD) formula e bazuar në serum të kreatininës, gjinisë, moshës dhe përkatësisë etnike; shih [www.cphiv.dk/tools.aspx](#). Ekuacioni Cockcroft-Gault (CG) mund të përdoret si një alternativë.
- viii Disa ekspertë rekomandojnë UA / C (raporti i albuminës kreatininës urinare) ose UP / C (raporti i proteinës kreatininës urinare) si një provë shqyrtimi për proteinurinë të të gjithë individët. UA / C kryesisht zbulon sëmundjen glomerulare. Përdoreni të individët me diabet. UP / C zbulon totalin e proteinave dytësore të sëmundjet glomerulare dhe tubolare. Skrinime shtesë janë të nevojshme për individët që marrin TDF dhe ndoshta për disa PI psh. ATV dhe LPV/r, shih [Nefrotoksiciteti shoqërues i ARV-ve](#)
- x Faktorët klasik të rrezikut: moshë më e vjetër, gjinia femër, hipog-onadizmi, historiku familjar me thyerje hijesh, BMI të ulët (≤ 19 kg / m²), mangësi e vitamins D, duhanpirja, pasiviteti fizik, historik thyerje me impakt të ulët, teprim me alkoolin (> 3 njësi / ditë), ekspozim ndaj steroideve (minimumi 5 mg për > 3 muaj).
- xi Instrument i i OBSH-se për vlerësimin e rrezikut të frakturës (FRAX[®]) shih: [www.shef.ac.uk/FRAX](#).
- xii Një diagnozë e COPD duhet të merret në konsideratë te personat mbi moshën 35, të cilët kanë një faktor rreziku (pi duhan aktualisht ose ish duhanpirës) dhe që shfaqen me frymëmarrje të shpeshtë, kollë kronike, prodhim të rregullt pështyme dhe bronshit të shpeshtë në dimër.

Pjesa II Terapia Antiretrovirale (TAR) e personave HIV-pozitivë

Vlerësimi i gadishmërisë së personave HIV-pozitivë për të Filluar dhe Vazhduar Terapinë Antiretrovirale (TAR)^(x)

Qëllimi: të ndihmojmë personat të fillojnë dhe / ose mbajnë terapinë Antiretrovirale	
<p>TAR e suksesshme kërkon gadishmërinë e një personi për ta filluar dhe përmbajtur regjimin gjatë gjithë kohës. Trajektorja nga ndërgjegjësimi i problemeve deri tek përmbajtja e TAR mund të ndahet në pesë faza. Duke ditur fazën e një personi, shëndetin, ofruarit e kujdesit shëndetsor përdorin teknika të përshtatshme për t'i ndihmuar ata për të filluar dhe mbajtur TAR.</p>	<p>Identifikoni gadishmërinë e personit duke përdorur teknikat WEMS⁽ⁱ⁾ dhe filloni diskutimin me një pyetje të hapur / ftesë: "Unë do të doja të flisnim për barnat e HIV-it." <Prit> "Çfarë mendoni për këtë?"</p> <p>Bazuar në reagimin e personit, identifikoni fazën e tij / saj të gadishmërisë dhe ndërhyri në përputhje me rrethanat⁽ⁱⁱ⁾</p>
Fazat e gadishmërisë për të filluar TAR	
<p>Prekontemplimi : "Unë nuk kam nevojë për të, unë ndihem mirë." "Unë nuk dua të mendoj për këtë."</p>	<p>Mbështetja: Tregoni respekt për qëndrimin e personit./ Mundohuni të kuptoni shëndetin e personit dhe besimet rreth terapisë. / Krijoni besim. / Ofroni informacion konçiz, të individualizuar / Lini takimin tjetër.</p>
<p>Kontemplimi : "Unë jam duke peshuar gjërat dhe ndjehem i shkatërruar në lidhje me ç'duhet të bëj.."</p>	<p>Mbështetja: Lejo ambivalencën. / Mbështet personin duke peshuar të mirat dhe të këqijat. / Vlerësoni nevojat e personit për informacion dhe mbështeteni atë gjatë kërkimit për këtë informacion. / Lini orarin e ardhshëm</p>
<p>Përgatitja: Unë dua të filloj terapinë, besoj se ilaçet do më lejojnë të bëj një jetë normale."</p>	<p>Mbështetja: Fuqizon vendimin e personit. / Vendosni me personin se cili është regjimi më i përshtatshëm. / Edukoni personin mbi adeherencën, rezistencën dhe efektet anësore. / Diskutoni integritimin në jetën e përditshme / Respektoni vetë-vlerësimin e personit. Pyesni: Sa besim keni se mund ti merrni medikamentet siç kemi diskutuar (specifik) në momentin që i keni filluar ato? Përdorni VAS 0-10⁽ⁱⁱⁱ⁾</p> <p>Merrni në konsideratë trajnimin e aftësive:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Trajnim mbi marrjen e medikamenteve, mundësisht MEMS • Terapia e vëzhgimit direkt me mbështetjen edukative. • Përdorni ndihmat: alarmin e telefonit celular, kutinë e ilaçeve; • Përfshini mjete mbështetëse / persona kur është e përshtatshme
<p>Veprim: "Unë do të filloj tani,"</p>	<p>Kontrolli i fundit: Me një plan trajtimi të mire-ndërtuar, a është person i aftë të marrë TAR?</p>
<p>Mirëmbajtja: "Unë do të vazhdoj", ose "Unë kam vështirësi në vazhdueshmërinë afat-gjate"</p> <p><i>Kushti: Personi mund të rikthehet në një fazë të parë, madje edhe nga "mirëmbajtja" drejt "zhytjes në mendime"</i></p>	<p>Vlerëso : Adeherencën çdo 3-6 muaj ^(iv)</p> <p>Vlerëso Adeherencën: Për personat me adeherencë të mirë: tregoni respekt për suksesin e tyre. Vlerëso: Perceptimet e vetëpersonit mbi aftësinë për t'u përmbajtur dhe vazhduar trajtimin. Pyet : Në 3-6 muajt e ardhshëm, sa besim keni se do të mund të merrni medikamentet? Përdorni VAS 0-10⁽ⁱⁱⁱ⁾</p> <p>Për një person me adeherencë të pamjaftueshme: përdorni teknikat e^(v) pasqyrit të problemeve, beni pyetje te hapura për të identifikuar mendimet jofunksionale. Vlerëso Fazën e gadishmërisë dhe ofro suportin bazë të fazës Vlerëso Pengesat dhe lehtësimet^(vi) Lini takim tjetër dhe përsëritni mbështetjen</p>
Skrinoni dhe flisni për problemet dhe lehtësimin e tyre	
<p>Konsideroni vlerësimin sistematik të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Depresionit^(vii), shih faqet 59-60 • Problemeve konjitive^(viii), shih faqen 63 • Dëmet nga alkooli^(x) apo përdorimi i drogës, shih faqen 28, 30 	<p>Konsideroni të flisni për:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mbështetjen sociale dhe deklarimin • Sigurimin shëndetsor dhe vazhdimësinë e barnave ARV • Faktorë të lidhur me Terapinë
<p>Njihni, diskutoni dhe zvogëloni problemet kudo që të jetë e mundur në një qasje multidisiplinare në grup.</p>	
<p>i. WEMS:Prit (> 3 sekonda), përsërit, pasqyro, përmblihd [1]</p> <p>ii. Personi i paraqitur në klinikë mund të jetë në faza të ndryshme të gadishmërisë: prekontemplimi, kontemplimi ose përgatitje. Hapi i parë është vlerësimi i kësaj faze dhe më pas mbështetja / ndërhyrja në përputhje me rrethanat. Në rastin e prezantimit të vonë (<350 qeliza CD4 / µL), fillimi i TAR nuk duhet vonuar. Personi duhet të ndiqet nga afër dhe gjithashtu mbështetur në mënyrë optimale. Lini orarin e ardhshëm të takimit brenda një kohe të shkurtër, dmth 1-2 javë.</p> <p>iii. VAS (=Shkalla vizuale analoge: shkon nga 0 në 10, dmth 0 = nuk do ta menaxhojë, 10 = jam i sigurt se do të menaxhojë).</p> <p>Nuk do ta menaxhojë Do ta menaxhojë</p> <p>0 ----- 10</p>	<p>një herë në javë, një herë në javë, një herë në çdo 2 javë, një herë në muaj, kurrë" / "A keni humbur më shumë se një dozë rradhazi?" [2].</p> <p>v. Pasqyrimi: reflektimi pas në kohë në lidhje me atë që një person ka thënë ose ka demonstruar jo-verbalisht (p.sh. inat dhe zhgënjim) PA prezantuar materiale të reja duke bërë pyetje ose duke i dhënë informacion.</p> <p>vi. Adeherenca në terapitë afatgjata [3].</p> <p>vii. Pyesni: "Gjatë muajit të kaluar a jeni ndjerë shpesh të shqetësuar, të rënë moralisht apo të pashpresë?" Gjatë muajit të fundit keni ndjerë me pak kënaqësi apo interes në gjërat që keni bërë?" / "A është kjo diçka në të cilën ju do të donit ndihmë?" / Në qoftë se përgjigjet janë pozitive, atëherë ndjeshmëria është 96%, specificiteti 89%[4].</p> <p>viii. Pyesni: "A ndjeheni të shqetësuar për t'u përqëndruar në jetën tuaj të përditshme?" / "A ndiheni të ngadalësuar në procesin e të menduarit?" / "A ndjeni që keni probleme me kujtesën tuaj?" / "A shprehen të afërmit apo miqtë tuaj se ndjehet se ju keni probleme me kujtesën ose vështirësi në procesin e të përqëndruarit?"[5].</p> <p>ix. Ne rekomandojmë AUDIT-Fast mjetin e shpejtë të kontrollit për të përcaktuar përdorimin e demshëm të alkoolit: "Sa shpesh keni pasur 6 ose më shumë njësi (nëse jeni femër), ose 8 dhe më shumë (nëse jeni mashkull), në një rast të vetëm në vitin e fundit?" Nëse përgjigja është çdo javë ose çdo ditë, shqyrtimi është pozitiv dhe ndalet këtu. Nëse përgjigja është më pak se kaq, bëni edhe tre pyetje të tjera. Gjatë shqyrtimit për përdorim të substancave të demshme, hiqni pyetjen e parë sa-siore dhe zëvendësoni fjalën "të pijshëm" me "substancë rekreative"[6].</p> <p>x. Algoritmi i përshtatur nga[7]</p>
<p>iv. Pyetje të sugjeruara në lidhje me adeherencën : "Në 4 javët e fundit sa herë e ke humbur dozën e barnave të tua HIV: Çdo ditë, më shumë se</p>	

Rekomandime për fillimin e terapisë Antiretrovirale tek personat HIV-pozitivë të paekspozuar më parë ndaj ART⁽ⁱ⁾

Rekomandimet janë vlerësuar duke marrë parasysh edhe shkallën e progresionit të sëmundjes HIV dhe praninë, apo rrezikun e lartë për të zhvilluar llojet e ndryshme të kondicioneve për bashkë-infeksione.

Kushtet e pranishme / rrethanat	Numërimin aktual CD4 ^(ii,iii)	
	350-500	> 500
Infeksioni HIV asimptomatik	C	C
Për të reduktuar transmetimin e HIV-it	C	C
Sëmundja simptomatike HIV (CDC B ose C kushtet) duke përfshirë tuberkulozin	R	R
Infeksioni primar HIV	C	C
Shtatzënia (përpara tremujorit të tretë)	R	R
Kushtet (gjasat ose mundësitë) të lidhura me HIV, përveç CDC faza B ose C e sëmundjes :	R	R
• Sëmundje të veshkave lidhur me HIV-in	R	R
• HIV-i i lidhur me dëmtime neurokonjitive	R	R
• Limfoma Hodgkin	R	R
• Kanceret e shoqëruar me HPV	R	R
• Të tjera kancere jo-AIDS që kërkojnë kimio dhe / ose radioterapi	C	C
• Sëmundje autoimune të pashpjegueshme ndryshe	C	C
• Rreziku i lartë për CVD (> 20% e vlerësuar prej riskut 10-vjet.) ose historikut të CVD	C	C
Hepatiti kronik viral:		
• HBV kërkon trajtim anti-HBV	R	R
• HBV nuk kërkon trajtim anti-HBV	R ^(iv)	C
• HCV për të cilin trajtimi anti-HCV është duke u konsideruar ose dhënë	R ^(v)	C
• HCV për të cilin trajtimi anti-HCV është duke u konsideruar ose dhënë	R	C

i,ii ART është gjithmonë e rekomanduar në çdo person HIV pozitiv me një numërim aktual të CD4 më poshtë se 350 qeliza / μ L .

Për personat me vlerë të CD4 më lartë këtij niveli, vendimi për të filluar TAR duhet të individualizohet dhe konsiderohet, veçanërisht në qoftë se një person ka kërkuar TAR dhe është gati për ta filluar terapinë, ka ndonjë nga kushtet e përmendura më lart dhe / ose për ndonjë arsye tjetër personale. Prioritet i duhet dhënë trajtimit të personave me numërim CD4 nën 350 qeliza / μ L dhe për personat me vlerë CD4 me të lartë në qoftë se ata vuajnë nga një prej kushteve të mësipërme para vendosjes në trajtim si parandalim. Koha gjithmonë duhet të merret në konsideratë për ta përgatitur personin, në mënyrë që të optimizoni respektimin dhe adeherencën. Testimi Genotipik i rezistencës është i rekomanduar para fillimit të TAR, idealisht në kohën e diagnozës me HIV; përndryshe para fillimit të TAR. Nëse TAR duhet të fillohet para se rezultatet genotipike të testimit të jenë në dispozicion, është e rekomanduar që të përfshijnë një PI të përforcuar me ritonavir në regjimin e linjës së parë. Para fillimit të trajtimit, niveli HIV-NV dhe matja e CD4 duhet të përsëriten për të marrë një nivel fillestar për të vlerësuar reagimin në vazhdim.

iii. Përdorimi R i TAR është i rekomanduar

Përdorimi C i TAR duhet të konsiderohet dhe në mënyrë aktive të diskutohet me personin HIV-pozitivë; në këto rrethana, disa ekspertë do të rekomandonin fillimin e TAR ndërsa të tjerë do të konsideronin shtyrjen e TAR. Kjo baraspeshë klinike pasqyron se ndërsa të dhëna të caktuara, të tilla si hipoteza mbi patofiziologjinë dhe aktivizimin kronik imunitar, mbështesin fillimin e TAR, kjo duhet të jetë e balancuar kundër rrezikut të reaksioneve të njohura apo të pazbuluara të medikamenteve nga përdorimi i ART dhe kështu raporti rrezik / dobi për përdorim të TAR nën këto rrethana ende nuk është përcaktuar mirë.

iv. Shih figurën në faqen 65 për indikacion të trajtimit HBV në personat me bashkë-infeksion HBV / HIV

v. Fillimi i TAR është i rekomanduar për të optimizuar rezultatet e trajtimit të HCV.

Regjimi i kombinuar fillestar për personat adult HIV-pozitivë naivë ndaj terapisë

TAR

Regjimet e Rekomanduara^(*)

Një ilaç nga kolona A duhet të jetë i kombinuar me ilaçet e listuara në kolonën B^(**)

A	B	Mbani Parasysh
NNRTI		
EFV ⁽ⁱ⁾ RPV ⁽ⁱⁱ⁾	ABC/3TC ^(vii) ose TDF/FTC	ABC/3TC bashkë-formulim TDF/FTC bashkë-formulim EFV/TDF/FTC bashkë-formulim RPV/TDF/FTC bashkë-formulim
FP/r		
ATV/r ^(iv) DRV/r ^(iv)	ABC/3TC ^(vii) ose TDF/FTC	ATV/r: 300/100 mg s/d (sasi ditore) DRV/r: 800/100 mg s/d
INSTI		
EVG + COBI	TDF/FTC	TDF/FTC/EVG/COBI bashkë-formulim ^(ix)
DTG	ABC/3TC ose TDF/FTC	DTG 50 mg TDF/FTC sd bashkë-formulim ABC/3TC/DTG bashkë-formulim
RAL	ABC/3TC ose TDF/FTC	RAL: 400 mg (dy herë në ditë)

Komponentët e Regjimeve Alternative

NNRTI	Mbani Parasysh
NVP ⁽ⁱⁱⁱ⁾	
FP/r	
LPV/r ^(v)	
FTRN	
TDF/3TC ZDV/3TC	ZDV/3TC bashkë-formulim
Frenuesi CR5	
MVC ^(vi)	Vetëm nëse CCR5 tropik i HIV-it ^(viii) i paliçensuar në Europë për personat naivë HIV pozitivë
Kombinimet Alternative	
DRV/r + RAL	Vetëm nëse CD4 > 200 cells/µL dhe HIV-NV < 100,000 kopje/mL
LPV/r + 3TC	Vetëm një studim i randomizuar në dispozicion

- * Vetëm barnat aktualisht të licensuara për fillimin e terapisë nga EMA, janë marrë në konsideratë (sipas rendit alfabetik).
- ** Barnat xhenerike të HIV-it janë bërë më të disponueshme dhe mund të përdoren për aq kohë sa ato zëvendësojnë të njëjtat ilaçe dhe nuk shkelin rekomandimet për dozat fikse të kombinuara.
- i EFV: nuk rekomandohet të fillohet tek gratë shtatëzëna ose tek gra pa kontracëpsion të sigurtë dhe konsistent; vazhdimi është i mundur nëse EFV tashmë ka filluar para shtatëzënisë; jo aktiv ndaj HIV-1 dhe HIV-2 të shtameve grupi O.
- ii RPV: vetëm nëse CD4 > 200 qel/µL dhe HIV-NV < 100,000 kopje/mL; PPI e kundërrindikuar, H2 antagonist të merren 12 orë para ose 4 orë pas RPV.
- iii NVP: Përdoren me shumë kujdes tek femrat me nivelin të CD4 > 250 qel/µL dhe meshkujt me nivel të CD4 > 400 qel/µL dhe vetëm nëse përfitimet e tejkalojnë riskun; jo aktiv ndaj HIV-1 dhe HIV-2 të shtameve grupi O.
- iv Studimi Castle (LPV/r vs. ATV/r) tregoi tolerancë më të mirë të ATV/r; [7]. Bashkëkombinimi me PPI është i kundërrindikuar tek personat me eksperiencë trajtimi. Nëse bashkëkombinimi gjykohej si i pashmangshëm, rekomandohet monitorimi i afërt klinik dhe dozat e PPI të të krahasueshme me omeprazol 20mg nuk duhet të tejkalohen dhe duhet të merren rreth 12 orë para marrjes së ATV/r. Studimi Artemis (LPV/r vs. DRV/r) tregoi efikasitet dhe tolerancë më të mirë të DRV/r [8].
- v Studimi ACTG 5142 tregoi efikasitet virologjik më të ulët të LPV/r përkundërs EFV. Nuk u shfaqën mutacione të PI me LPV/r + 2 NRTI të dështuara. Mutacionet e PI janë vërejtur me LPV/r + dështimet e EFV. LPV të përdoret në rastet kur përthithja nga goja është e vetmja alternativë, veçanërisht në kujdesin intensiv [9].
- vi Jo i liçensuar në Europë për personat naivë.
- vii Kundër- indikacion i ABC-se nëse HLA B*5701 është pozitive. Edhe nëse HLA B*5701 është negative, këshillimi për riskun e HSR ende i de tyrueshëm. ABC duhet të përdoret me kujdes në personat me rrezik të lartë CVD dhe/ose personat me ngarkesë virale > 100,000 kop-je/µL.
- viii Vetëm në rast padisponueshmërie ose intolerance ndaj NRTI të tjera të rekomanduara
- ix Nuk duhet të fillohet tek personat me eGFR < 70 mL/min. Rekomandohet që EVG/COBI/TDF/FTC të mos fillohet tek personat me eGFR < 90 mL/min, përveç rasteve që ky është trajtimi i preferuar.

Infeksioni Akut i HIV-it

Përkufizimi i Infeksionit Akut primar i HIV-it

Ekspozim me rrezik të lartë brenda 2-8 javëve të mëparshme, dhe

- NV-HIV në plazmë e dedektueshme (p24 Ag dhe/ose NV-HIV > 1000 kopje/mL) dhe/ose
- Testi serologjik negativ ose i papërcaktuar (ELISA negativ ose pozitiv i dobët, dhe WB ≤ 1 band) plus NV-HIV
- Rekomandim: të konfirmohet infektimi me HIV nëpërmjet kryerjes së testit për anti-trupa (WB) 2 javë më vonë

Trajtimi

- Trajtimi duhet të konsiderohet tek të gjithë personat. Shih faqen 7
- Nëse trajtimi merret në konsideratë, personi HIV pozitiv duhet me preferencë, të përfshihet në një studim klinik
- Disa ekspertë rekomandojnë mjekimin si mjet për parandalimin e transmetimit të HIV-it

Testimi për Rezistencën

- Rekomandohet në të gjitha rastet, menjëherë sapo kemi një diagnozë të infeksionit akut të HIV-it, edhe nëse trajtimi nuk ka filluar
- Në rast se nuk mund të kryhet, të ruhet një mostër plazme për testim

Transmetimi

- Të identifikohen IST-t, përfshirë sifilizin, gonorrenë, klamidian (uretritit dhe LGV), HPV, HBV dhe HCV, shih faqen 56
- Këshilloni personin e diagnostikuar rishtazi mbi rrezikun e lartë të transmetimit dhe masave parandaluese (kondomet), duke përfshirë njoftimin dhe testimin e partnerve

Strategjitë e ndryshme për personat me virologji të supresuar

Përkufizimi i virologjisë së supresuar

NV për HIV e konfirmuar < 50 kopje/mL

Treguesit

Ndryshoj për toksicitetin

- Toksicitet i dokumentuar
- Menaxhimi i ndërveprimeve të mundshme të ilaçeve
- Efektet anësore
- Shtatzëni e planifikuar

Ndryshoj për parandalimin e toksicitetit afatgjatë

- Parandalimi i toksicitetit afatgjatë (kalim i hershëm në parandalim)
- Plakja dhe / ose bashkë-sëmundshmëria me një ndikim të mundshëm negativ të ilaçit-eve në regjimin aktual, p.sh. në rrezikun për CVD, parametrat metabolikë.

Ndryshoj për thjeshtësimin e regjimit

Duam të lehtësojmë regjimin

Regjimi aktual nuk është më i rekomanduar

Parimet

1. Një PI/r mund të ndërpritet për thjeshtësimin, parandalimin apo përmirësimin e anomalive metabolike ose lehtësimin e adeherencës për dozë fikse ATV, një NNRTI, RAL ose EVG + COBI vetëm nëse aktiviteti i plotë i 2 NRTI të mbetur në regjim mund të jetë i garantuar
2. Thjeshtimi i një regjimi kompleks shumë-medikamentoz në personat me përvojë antiretrovirale me 1) zëvendësimin e barnave të vështira për t'u administruar (ENF) dhe /ose me aktivitet të dobët (NRTI në rast të rezistencës së shumfishtë të NRTI) dhe / ose të tolerancës së dobët dhe 2) shtimin e barnave të reja, të tolerueshme më mirë, të thjeshtë dhe agjent(ve) aktivë.
3. Ofronet kalimi në doza ditore NRTI ose PI/r për thjeshtim, parandalim të toksiciteve afat-gjatë
4. Bëhet kalimi në klasa të ndërmjetme për barna specifike në qoftë se ka ngjarje të ngjashme të pafavorshme.
5. Rishikimi i historikut të plotë të ARV-ve dhe vihen në dispozicion rezultatet e testimit të rezistencës.
6. Shmangni kalimin tek një ilaç me barrierë të ulët gjenetike, në prani të një skeleti të kompromentuar për shkak të një rezistence të depozituar.

Strategji që nuk rekomandohen

- a. Terapi me ndërprerje, ndërprerje të shkurtra ose të zgjatura të mjekimit.
- b. Kombinim me 2-ilaçe, psh. 1 NRTI + 1 NNRTI ose 1 NRTI + 1 PI pa RTV-in ose 1 NRTI + RAL, ose 2 NRTI .
- c. Kombinim i trefishtë i NRTI-ve.

Strategji të tjera

Monoterapia me PI/r me sasinë ditore të DRV/r, apo me dhënie dy herë në ditë të LPV/r, mund të përfaqësojë një opsion të mirë për personat jo tolerantë ndaj NRTI-ve ose për thjeshtimin e trajtimit ose tek përdoruesit e drogave të paligjshme me ndërprerje të dokumentuar dhe të shpeshtë të TAR-it të kombinuar. Strategji të tilla aplikohen vetëm tek personat pa historik dështimi në terapi të mëparshme me PI dhe që kanë pasur NV < 50 k/mL për të paktën gjatë 6 muajve të kaluar dhe që nuk kanë HepB kronik. LPV / r + 3TC ose ATV / r + 3TC mund të jenë mundësi më të mira.

Dështimi Virologjik

Përkufizimi	Nivel i konfirmuar i HIV-VL > 50 kopje/mL, 6 muaj pas fillimit të terapisë (fillim ose modifikim) në persona që vazhdojnë terapinë me Antiretrovirale (TAR). Në varësi të ecurisë së NV, ky limit kohor mund të jetë më i lartë ose më i ulët.
Masa të përgjithshme	<p>Rishikim i virilitetit të prishëm të regjimit të mjekimit</p> <p>Vlerësim i adeherencës, përputhjes, tolerancës, ndërveprimit midis medikamenteve, ndërveprimit midis medikamenteve dhe ushqimit, çështjeve psiko-sociale.</p> <p>Kryerja e testeve të rezistencës në rastin e dështimit të terapisë (zakonisht të disponueshëm për nivele HIV /VL> 350-500 kopje/mL dhe në laboratorë të specializuar për nivele të ulëta viremie) dhe marrja e historikut mjekësor mbi analizat e mëparshme të rezistencës mbi mutacionet e dokumentuara.</p> <p>Testi i Tropizmit</p> <p>Të konsiderohet monitorimi terapeutik i medikamenteve (TDM)</p> <p>Të rishikohet historia e terapisë Antiretrovirale</p> <p>Identifikoni mundësitë e trajtimit, si dhe bar-nat/kombinimet aktive dhe potencialisht aktive</p>
Menaxhimi i dështimit virologjik (DV)	<p>Nëse HIV-VL > 50 dhe <500-1000 kopje/mL</p> <p>Kontrollo për adeherencën</p> <p>Kontrollo nivelin e HIV-VL pas 1 deri në 2 muaj</p> <p>Nëse testi i genotipit nuk është i mundur, merret në konsideratë ndryshimi i regjimit, bazuar në historikun e mëparshëm të trajtimit dhe rezistencës.</p> <p>Nëse HIV-VL> 500/1000 kopje/mL, të ndryshohet menjëherë trajtimi: ndryshimet do të jenë në varësi të rezultateve të testeve të rezistencës:</p> <p>Nuk janë gjetur ndryshime (mutacione) të rezistencës; rikontrolloni për adeherencën, të kryhet TDM</p> <p>Janë gjetur ndryshime (mutacione) të rezistencës: të kalohet në një regjim të supresuar bazuar në historinë e mjekimit; këshillohet diskutimi me ekspertë nga fusha të ndryshme.</p> <p>Synimi i regjimit të ri: HIV-VL < 400 k/mL pas 3 muajsh, HIV-VL< 50 k/mL pas 6 muajsh.</p>

Në rast të shfaqjes së ndryshimeve (mutacioneve) të rezistencës	<p>Rekomandime të përgjithshme:</p> <p>Të përdoren 2 ose më mirë 3 medikamente aktive në regjimin e ri (përfshirë medikamentet aktive të klasave të përdorura më parë)</p> <p>Në çdo skemë mjekimi duhet të përdoret të paktën 1 PI/r plotësisht aktiv(e.g. DRV/r) plus 1 ilaç nga një klasë e papërdorur më parë p.sh frenues të fuzionimit, frenues të integrazës ose CCR5 antagonist (nëse testi për tropizëm tregon vetëm virusin R5) ose 1 NNTRI (psh. ETV), të vlerësuara nga testet mbi genotipet.</p> <p>Ndryshimi të shtyhet për më vonë nëse janë në dispozicion < 2 medikamente aktive, bazuar në të dhënat mbi rezistencën, përveç personave me numër të ulët CD4 (<100cell/μL) ose me rrezik të lartë të përkeqësimit klinik, synimi për të cilët është ruajtja e funksionit imun, nëpërmjet frenimit të pjesshëm të HIV-VL(>1*log10 reduktim) nëpërmjet riciklimit.</p> <p>Nëse mundësitë janë të kufizuara, shqyrtoni përdorimin e medikamenteve të reja dhe eksperimentale, duke favorizuar studimet klinike (por shmangni monoterapinë funksionale)</p> <p>Nuk rekomandohet ndërprerja e trajtimit.</p> <p>Merrni në konsideratë vazhdimin e 3TC apo FTC në veçanti, edhe nëse është dokumentuar një mutacion i rezistencës (M184V/I).</p> <p>Nëse keni shumë mundësi në dispozicion, kriteret për zgjedhjen e parapëlqyer përfshijnë: thjeshtësi të skemës së regjimit, vlerësimin e rrezikut toksik, ndërveprimit midis medikamenteve dhe skemat mjekuese shpëtuese për të ardhmen.</p>
--	---

Trajtimi i grave shtatzëna HIV pozitive

Gratë shtatzëna duhen kontrolluar çdo muaj dhe sa më shpesh e mundur afër datës së pritshme të lindjes

Kriteret për nisjen e TAR-it tek gratë shtatzëna (shiko variantet e ndryshme)	Të njëjta si për jo-shtatzënat
Objektivi i trajtimit për gratë shtatzëna	Frenim i plotë i HIV-VL gjatë tremujorit të tretë dhe veçanërisht në momentin e lindjes.
Testimi i rezistencës	E njëjtë si për jo-shtatzënat, d.m.th para se të fillohet TAR dhe në rastin e dështimit virologjik.
VARIANTET	
1. Gratë planifikojnë të ngelen shtatzëna ndërsa janë në TAR.	1. Nëse janë nën EFV, kaloni tek një tjetër NNTRI ose dozë të plotë PI për shkak të rrezikut të keqformimeve të tubit neural
2. Gratë ngelen shtatzëna ndërsa janë në TAR.	2. Vazhdimi i TAR vetëm nëse është nën efektin e EFV: kaloni në një tjetër agjent (NVP ose PI/r) nëse është e mundur para javës së tetë të shtatzënisë, (për shkak të rrezikut të keqformimeve të tubit neural)
3. Gratë ngelen shtatzëna dhe nuk kanë marrë më parë mjekim (naive) pavarësisht nëse plotësojnë kriteret (CD4) për fillimin e TAR	3. Fillimi i TAR-it në fillim të tremujorit të 2-të është shumë i rekomanduar
4. Gratë tek të cilat ndjekja fillon pas javës së 28-të të shtatzënisë.	4. Fillohet TAR menjëherë dhe konsiderohet shtimi i RAL për të arritur sa më shpejtë rënien e NV, në raste të niveleve të larta të NV.
5. Gratë tek të cilat NV nuk është e padedektueshme në tremujorin e tretë të shtatzënisë	5. Kryhet testi i rezistencës dhe konsiderohet shtimi i RAL-it për të arritur sa më shpejtë uljen e NV
Trajtimi me Antiretroviralë gjatë shtatzënisë	E njëjtë si për jo-shtatzënat; Të mos fillohet NVP, por mund të vazhdohet në rast se e kanë filluar para shtatzënisë. Përdorimi i EFV duhet të shmanget gjatë tremujorit të parë të shtatzënisë për shkak të rrezikut të keqformimeve të tubit neural* Midis PI/r, preferohen LPV/r, SQV/r ose ATV/r Nëse RAL, DRV/r: mund të vazhdohen
Kundër indikacionet e barnave gjatë shtatzënisë	ddI + d4T, në kombinime treshe të NRTI
Zidovudinë intra venoze gjatë procesit të lindjes	Përfitimi është i paqartë nëse niveli i NV < 50 kopje/mL
Një dozë e vetme NVP gjatë lindjes	Nuk rekomandohet
Seksion çezarian	Përfitimi është i paqartë nëse niveli i NV < 50 kopje/mL gjatë javës së 34-36. Në këtë rast, merret në konsideratë vetëm lindja vaginale

* Sipas studimeve prospektive [10-11]

TAR në Bashkë-Infeksionet HIV/TB

Parimet

Personat me TB duhet të fillojnë me terapi standarde të mjekimit të TB-s me 2 muaj Rifampicin/Isoniazid/Pyrazinamide +/- Ethambutol e ndjekur nga 4 muaj Rifampicin/Isoniazid (zgjedhja e barnave dhe kohëzgjatja e mjekimit varet nga ndjeshmëria e barnave dhe vendi i sëmundjes), shih [Diagoza dhe Mjekimi i tuberkulozit në personat HIV-pozitiv](#)

Të gjithë personat me bashkë-infeksion të HIV-it me TB duhet të fillojnë TAR pavarësisht nga niveli i CD4. Mbikëqyrja e trajtimit dhe vlerësimi i adeherencës janë shumë të rëndësishme.

Koha e sugjeruar për fillimin e TAR tek bashkë-infeksionet HIV/TB sipas nivelit të CD4

< 100 qel/ μ L(*) Sapo trajtimi për TB tolerohet dhe kurdo që të jetë e mundur brenda 2 javësh

> 100 qel/ μ L(**) Mund të shtyhet deri në mes të javës së 8 dhe 12 të trajtimit të tuberkulozit, veçanërisht kur ekzistojnë vështirësi me ndërveprimet midis barnave, adeherimin dhe toksicitetin

Edhe pse studimet RCT tregojnë se TAR i hershëm (brenda 2 javësh) nuk e redukton vdekshmërinë në meningjitet e TB-s, rekomandimet për fillimin e TAR duhet të bazohen në nivelin e qelizave CD4 të personave HIV-pozitivë me bashkë-infeksion të TB-s.

* Tregoni kujdes ndaj reagimeve IRIS tek personat që fillojnë TAR në nivele të ulëta të CD4 dhe me fillimin e hershëm të ARV-ve. Kortikosteroidet duhet të merren në konsideratë për trajtimin e simptomave IRIS, me dozat dhe kohëzgjatjen të përshtatura sipas përgjigjes.

** Edhe pse të dhënat sugjerojnë një nivel 50 qel/ μ L, për shkak të variabilitetit të përditshëm të CD4, një nivel i 100 qel/ μ L, mund të jetë më i përshtatshëm.

Rekomandime për linjën e 1-rë të kombinimeve të ARV-ve me mjekimet kundër-TB-s

TDF/FTC/EFV, ABC/3TC/EFV ose TDF/FTC/RAL

Mjekime Alternative

- Nëse NV< 100,000 kopje/mL, kombinim me dozë fikse e ABC/3TC/ZDV dy herë në ditë +/- TDF mund të përfaqësoj gjithashtu një alternativë afatshkurtër derisa trajtim anti-TB të ketë përfunduar.
- Rifampicin plus dozë dyfishë LPV/r ose me RTV në dozë të rritur (400 mg dy herë në ditë) + LPV Kur kombinimet nuk janë të rekomanduara ose që duhet të përdoren me kujdes, apo për shkak të rezistencës / intolerancës, duhet të kërkohet këshilla e specialistit për trajtimin e HIV-it.

- PI/r + TDF/FTC, duke përdorur rifabutin në vend të Rifampicinës
- Përdoreni me kujdes

Ndërveprime të rëndësishme midis barnave ARV dhe Rifampicin / Rifabutin

Klasa e Barnave ARV	ARV Specifike	Ndërveprimet midis barnave dhe rekomandimet e rregullimit të dozave i disa ose të gjitha barnave
NRTI-të		Rifampicin: Doza standarde për të gjitha barnat Rifabutin: Doza standarde për të gjitha barnat
	FP/r	Rifampicin: nuk rekomandohet
NNRTI-të	ATV/r, DRV/r, LPV/r ose SQV/r	Rifabutin: doza 150 mg x 3/javë(i). PI/r; në dozë standarde
	Monitorimi i enzimeve të melcisë dhe sa herë është e mundur, të kryhet TDM për PI/r	
	EFV	Rifampicin: Nuk kërkohet ndryshimi i dozës. EFV: dozë standarde (disa rekomandojnë 800 mg nëse nuk është Afrikan); ARV TDM rekomandohet pas 2 javësh Rifabutin: 450 mg në ditë. EFV: dozë standarde
	NVP	Nuk rekomandohet as Rifampicin as Rifabutin
INSTI	RPV	Rifampicin: Nuk rekomandohet Rifabutin: dozë standarde. Doza e RPV duhet rritur (përdoreni me kujdes)
	ETV	Rifampicin: Nuk rekomandohet Rifabutin: dozë standarde e të dyja barnave (të dhëna të pakta – përdoreni me kujdes)
	EVG	Rifampicin: Nuk rekomandohet Rifabutin: 150 mg x 3/javë. EVG: dozë standarde
INSTI	RAL	Rifampicin: dozë standarde. RAL 800 mg dy herë në ditë dhe rekomandohet TDM për RAL (doza standarde gjithashtu mund të funksionoj) Rifabutin: dozë standarde për të dyja barnat

i Studime fillestare farmakokinetike tek vullnetarë të shëndetshëm treguan se përqëndrimet e Rifabutinës dhe metabolitet e saja aktive rriten dukshëm kur kombinohen me PI / r. Kështu, një reduktim i dozës së Rifabutinës me 150 x3 mg / javë rekomandohet për të zvogëluar rrezikun e toksicitetit të lidhur me Rifabutinën. Megjithatë, të dhënat më të fundit farmakokinetike të ardhura nga personat me bashkë-infeksion HIV / TB tregojnë se dhënia e kombinuar e LPV / r apo ATV / r me Rifabutin (150 x3 mg / javë) rezultoi në përqëndrime të Rifabutinës më të ulëta se ato të vëzhguara me Rifabutin 300 mg x1 / ditë pa përdorur PI / r, duke sugjeruar kështu që dozimi i Rifabutinës mund të jetë i pamjaftueshëm. Rastet e relapsit me TB Rifamycin-rezistente, janë gjetur të përshkruara tek personat me bashkë-infeksion, të trajtuar me Rifabutin 150 x3 mg / javë dhe LPV / r apo ATV / r. Udhëzimet e SHBA-së për trajtimin e HIV-it rekomandojnë administrimin e Rifabutinës në sasinë 150 x1 mg / ditë me PI / r. Për shkak të të dhënave të kufizuara rreth sigurisë me këtë dozë dhe kombinim, personat që trajtohen me Rifabutin 150 x1 mg / ditë me PI / r duhet të monitorohen nga afër për toksicitetin e lidhur me Rifabutinën (dmth uveitis ose neutropenia).

Profilaksia Pas-ekspozimit

Profilaksia Post-ekspozimit (PEP) rekomandohet në rastet e

Rezikulu	Natyra e ekspozimit	Statusi i personit infektues (burimi)
Gjaku	Penetrim subkutan ose intramuskular me aqë intra venoze (IV) ose, intra muskulare (IM) ose me pajisje intravaskulare	HIV pozitiv, ose serostatusi i panjohur, por me prezencë të faktorëve të riskut për HIV
